

INTEGRIMI I SHËRBIMEVE PSIKO-SOCIALE NË KSHP

**Drejt përmbushjes së nevojave mjekësore,
psikologjike dhe sociale të qytetarëve.**



1. PËRMBLEDHJE

Mbështetja e Projektit HAP për fuqizimin e ekipeve ndërprofesionale shëndetësore dhe psiko-sociale në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) ka qenë e rëndësishme për rritjen e kapaciteteve të sistemit në adresimin e nevojave komplekse shëndetësore, psikologjike dhe sociale të grupeve vulnerabël. Kjo mbështetje ka synuar identifikimin e hershëm, menaxhimin e koordinuar dhe referimin e duhur të pacientëve që kanë nevojë për kujdes të integruar shëndetësor, psikologjik dhe social.

2. KONTEKSTI DHE NEVOJA

➤ Shqipëria po përballlet me:

- plakje të popullsisë
- rritje të sëmundjeve kronike
- barrë në rritje të çrregullimeve të shëndetit mendor

➤ Tradicionalisht, KSHP-ja:

- ka ofruar shërbime klinike mjekësore dhe infermierore;
- nuk ka ofruar shërbime psikosociale.

➤ Përvoja ndërkombëtare tregon se:

- faktorët psikosocialë janë përcaktues të rëndësishëm të shëndetit;
- shërbimet psikosociale në KSHP përmirësojnë shëndetin e pacientëve;
- bashkëpunimi ndërprofesional përmirëson aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore.



3. ÇFARË SJELL INTEGRIMI I SHËRBIMEVE PSIKOSOCIALE NË KSHP

- Identifikim më të hershëm të nevojave shëndetësore, psikologjike dhe sociale;
- Menaxhim të koordinuar të rasteve komplekse në KSHP;
- Referim të standardizuar në përputhje me nevojat e pacientit drejt shërbimeve komunitare dhe sociale;
- Përmirësim të vazhdimësisë së kujdesit;
- Reduktim të barrierave të aksesit për grupet vulnerabël.



4. KUADRI STRATEGJIK DHE INSTUCIONAL I SHËRBIMEVE PSIKOSOCIALE NË KSHP

- Strategjia e KSHP-së 2020–2025 parashikon zhvillimin e shërbimeve të integruara socio-shëndetësore për grupet vulnerabël.
- Plani i veprimit për shëndetin mendor në Shqipëri 2023-2026.
- Dokumenti politik për moshimin dhe Plani i Veprimit 2025–2030.
- Transformimi i qendrave shëndetësore në Qendra Socio-Shëndetësore (Urdhri Nr. 413, 13.07.2022) dhe integrimi i stafit psikosocial në KSHP.
- Punësimi i rreth 100 profesionistëve psikosocialë.



5. GRUPET PËRFITUESE KRYESORE

- Të moshuarit (përfshirë ata që jetojnë vetëm)
- Personat me aftësi të kufizuara
- Personat me çrregullime të shëndetit mendor
- Personat me vështirësi në aksesin fizik ndaj qendrave shëndetësore
- Individët dhe familjet në situata sociale vulnerabël

6. KONTRIBUTI I HAP

6.1 Profilet e profesionistëve në KSHP

Janë hartuar dhjetë profile të punonjësve të KSHP-së, përfshirë edhe profilet e punonjësit social dhe të psikologut në këtë nivel shërbimesh.

6.2 Shëndeti Mendor në KSHP

Është hartuar [Udhëzuesi për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në Kujdesin Shëndetësor Parësor](#), i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vitin 2022.

Për zbatimin e tij në periudhën 2023-2026:

- Janë mbështetur **140/356 Qendra Shëndetësore (36%)**.
- **472 profesionistë** u trajnuan përmes Trajnimeve për Trajnerë (ToT). Trajnimet përfshinë mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë dhe staf të NJVKSH-ve.
- **1294 profesionistë** kanë marrë pjesë në Grupe Kolegësh për të përforcuar zbatimin e udhëzuesit të shëndetit mendor në terren dhe të gjithë janë pajisur me *“Udhëzues për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP”*.

6.3 Shërbimi psiko-social në KSHP

- Është hartuar [Manuali i Psikologut në KSHP](#), miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 103, datë 2 shkurt 2024, i cili:
 - Përcakton rolin dhe përgjegjësitë e psikologut;
 - Qartëson bashkëpunimin me mjekun, infermierin dhe punonjësin social;
 - Standardizon praktikat profesionale.
- * Trajnimet për përdorimin e tij janë aktualisht në proces.
- Është hartuar [Manuali Praktik i Punonjësit Social në KSHP](#), miratuar me Urdhrin Nr. 303, datë 28 prill 2026, i cili:
 - Përcakton funksionet dhe proceset kryesore të punës;
 - Vendos standardet e shërbimeve sociale në qendrat shëndetësore;
 - Përmirëson menaxhimin e strukturuar të rasteve dhe referimin.
- * Trajnimet për përdorimin e tij janë aktualisht në proces.

6.4 Inventari i Shërbimeve Socio-Shëndetësore

- Janë përpiluar dhe publikuar inventarë të shërbimeve socio-shëndetësore në gjashtë bashki: [Shkodër](#), [Lezhë](#), [Fier](#), [Korçë](#), [Durrës](#), [Elbasan](#).
- Këto dokumente listojnë ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve, duke ndihmuar ekipet e KSHP-së të referojnë pacientët drejt shërbimeve plotësuese që nuk ofrohen nga qendra shëndetësore.
- Dokumentet e rrjeteve lokale të shërbimeve socio-shëndetësore mund të shkarkohen në faqen zyrtare të HAP (www.hap.org.al > Publikime).

7. REZULTATET DHE NDIKIMI

PËRMIRËSIM I MENAXHIMIT TË ÇRREGULLIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR

Ekipet e KSHP-së janë më të afta të identifikojnë dhe menaxhojnë çrregullimet e zakonshme të shëndetit mendor.

RRITJE E AKSESIT PËR SHËRBIMET SOCIO-SHËNDETESORE LOKALE

Ekipet e KSHP-së janë më të informuara për rrjetet lokale të shërbimeve socio-shëndetësore, gjë që mundëson akses më të mirë për grupet në nevojë për këto shërbime.

BASHKËPUNIM NDËRPROFESIONAL MË I FORTË

Trajnimi i përbashkët i mjekëve, infermierëve, psikologëve dhe punonjësve socialë ka përmirësuar koordinimin dhe punën në ekip.

INSTITUCIONALIZIMI I ROLEVE TË REJA

Manualet e miratuara përcaktojnë qartë funksionet dhe përgjegjësitë e psikologut dhe punonjësit social në KSHP.

